




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr Prot. Br Prot Prot No	01-118/2013
Data Datum Date	22-01-2013
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.01.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3747/12, për ztr. *Riad Rashiti* – Drejtor i Drejtorise për zhvillim ekonomik në Komunen e Gjilanit, *për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.***

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-3747-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Riad Rashiti – Drejtor i drejtorisë për zhvillim ekonomik në Komunën e Gjilanit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 2, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në një biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit, konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, ztr.Rashiti, është paraqitur, në takim me zyrtaret e Agjencisë, gjatë të cilit është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas kësaj bisede, zyrtari i lartë, ztr. Riad Rashiti ka deklaruar se do të filloj procedurat e ndryshimit të kësaj gjendje, konform Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë zyrtari Rashiti, në Agjencinë kundër Korrupsionit ka ofruar dokumentin me nr.protokoli DPKI/03-4571/12 në të cilin shihet se të njejtit i është aprovuar dorëheqja nga Kompania e Sigurimeve "Grawe Elsig" sh.a. te e cila kishte një funksion menagjues, që krahas funksionit të tij zyrtar shkaktonte konflikt interesi.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik.
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

